



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:008688
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05761534

C.nr.71/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike të paditësve Gj.P., , Z.D., , që të dy nga Gjakova dhe A.R., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilët me autorizim i përfaqëson Av.Urim Rexha nga Gjakova, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”..”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Y.M., jurist nga Prishtina, vlera e kontestit 6,000.00 euro, me bazë juridike kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 31.05.2024 merr këtë :

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve Gj.P-T., , nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, A. R., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, Z.D., nga Gjakova, e parashtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ...” me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike kontestimore.

II.Secila nga palët bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësit Gj.P., , Z.D., , që të dy nga Gjakova dhe A.R., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të tyre Av.Urim Pozhegu, në këtë gjykatë me datë 23.01.2020 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”..”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin kryesor për datën 31.05.2024 me fillim në ora 09:00, në të cilën nuk kanë prezentuar palët ndërgjyqëse edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e kanë arsyetuar. I autorizuari i paitësve me parashtrësën e datës 08.05.2024 e ka tërhequr padinë, me arsyetimin se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësve të konstatohet e tërhequr në kuptim të nenit 261 par. 2 dhe 3 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261 par. 2 dhe 3 lidhur me nenin 387 parag. 1, pika c) të LPK –së.

Numri i lëndës: 2020:008688
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05761534

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Përgjithshëm -
C.nr.71/2020, datë 31.05.2024

Gjyqtari
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së, nuk lejohet ankesa.